



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 38, Datë 07.03.2019

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “KASTRATI ENERGY” SH.P.K., NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37 pika 2, gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “e”; nenit 5, pika 1, gërma “e” dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, nenit 15 të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 07.03.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e licencimit dhe monitorimit të tregut mbi kërkesën e shoqërisë “Kastrati Energy” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Kastrati Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 111 Prot., datë 01.02.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
- Bordi i ERE-s me Vendimin nr. 22, datë 19.02.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Kastrati Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Pas kësaj vendimarrje, ERE me shkresën nr. 32/5 Prot., datë 18.02.2019, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe mbas përfundimit të afatit, rezultoi se nuk ka patur palë të interesuara.
- ERE me shkresën nr. 111/1 Prot., datë 19.02.2019, dërgoi pranë subjektit njoftimin e vendimit, si dhe bëri me dije për mungesën e dokumentacionit të konstatuar në aplikim.
- Shoqëria “Kastrati Energy” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 111/2, datë 20.02.2019, ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar.
- Aplikimi i shoqërisë “Kastrati Energy” sh.p.k plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “Kastrati Energy” sh.p.k në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 (pesë) vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

**NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola SADUSHI**